

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"AI Systems"**

**KREU I  
Dispozita te Pergjithshme**

Sot, në datën 14.12. 2021 (dymijë e NJEZET E NJE) personat e mëposhtem:

1. **Z. PETRILLI FELICE ROBRTO**, i biri i Antonio, shtetas Italian, lindur ne CANOSA DI PUGLIA me 12/06/1971 banues ne Canosa di Puglia Via Venezia nr 16 , mbajtes i pasaportes italiane me numer YA8459510;
2. **Z. TRAVERSA CARLO**, i biri i Luigi, shtetas Italian, lindur ne BARLETTA me 31/05/1972 dhe banues ne BARLETTA C.so Garibaldi 226 , mbajtes i katrtesidentitetit italiane me numer CA50691EC,

ne cilesine e "Ortakeve Themelues", me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", vendosen te themelojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "**AI Systems** " SHPK.

**KREU II  
Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore**

**Neni 1  
EMRI**

- 1.1 Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas formes "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" dhe mban emrin "**AI Systems** " SHPK.
- 1.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash,në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

**Neni 2  
Objekti**

Shoqeria "**AI Systems** " SHPK.

ka per objekt, si ne Shqiperi ashtu edhe jashte territorit te saj, zhvillimin e aktiviteve te mëposhteme:

- Furnizim projektim dhe instalim te sistemeve informatike per kompani publike dhe private, qofte software dhe hardware
- Furnizim projektim dhe instalim te sistemeve gestional dhe er psi dhe sisteme te menaxhimit te prodhimit
- Furnizim projektim dhe instalim te sistemeve te inteligjences artificiale
- Furnizim projektim dhe instalim te sistemeve IoT(internet of Thinks)
- Furnizim projektim dhe instalim te sistemeve elektronike, mekanike ose informatike per automatizimin industrial
- Furnizim projektim dhe instalim te sistemeve te Realitetit virtual (Realtà virtuale)
- Furnizim projektim dhe instalim te sistemeve online te marketingut ne vecanti
- Furnizim projektim te sistemeve telekomunikacione
- Konsulence organizimi dhe drejtimiper organizata publike dhe private
- Aktivitete te formimit
- Cdo lloj aktivitei tjeter qe lejohet te zhvillohet sipas legjislacionit shqiptare

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

- 3.1 Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, me përjashtim të rastit kur Asambleja e Ortakëve, sipas kuorumit përketes vendos ndryshe.
- 3.2 Shoqëria "AI Systems" SHPK.  
✓ gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin tregtar të QKR-se.

**Neni 4**  
**Zyra Qendrore**

- 4.1 Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në adresën: **Sheshi Skenderbej, Pallati i Kulturës, Kati i 1 – Tiranë**
- 4.2 Gjate veprimtarisë së saj, shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi edhe në qytete të tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme dhe në përputhje me legjislacionin e kërkuar në fuqi sipas juridiksionit të vendit përketes.

**KREU III**

**Neni 5**  
**Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar**

- 5.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është **LEKE 100.000** (njëqind mijë leke), i barabartë me 2 (dy) kuota. Kontributet e ortakëve përbejnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.
- 5.2 Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë është në raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotes të secilit ortak, llogaritet në raport me secilin kontribut, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur sipas grafikut të mëposhtem:

Nr.	Emri i Ortakëve	Kuota	Kontributi i ortakëve ne kapital (leke)	Perqindja ne kapital
1.	<b>PETRILLI FELICE ROBRTO</b>	1	50.000	50%
2.	<b>TRAVERSA CARLO</b>	1	50.000	50%
<b>Totali</b>		<b>2</b>	<b>100.000</b>	<b>100 %</b>

- 5.3 Kontributet sa më sipër janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ana e ortakëve të shoqërisë.

**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përketës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri,

miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

**6.2** Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh që të respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

#### **KREU IV**

##### **Neni 7**

##### **Transferimi i Kuotave**

- 7.1** Transferimi (përfshirë shitje dhe ose dhurimin dhe ose cedimin dhe ose kalimin) inter vivos të kuotave të shoqërisë tek pale të treta i nënshtrohet të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve të tjerë ekzistues, të cilët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë sipas kushteve të parashikuara në nenin 7.2 më poshtë.
- 7.2** Në rast se një ortak (këtë e tutje i quajtur Ofruesi) kërkon të transferojë disa ose të gjitha kuotat ose kontributet e zotëruara prej tij në shoqëri, ortakët e tjerë (këtë e tutje të quajtur Ortakët e tjerë) gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotat që ofrohen për transferim (këtë e tutje të quajtur Kuotat e ofruara), sipas afateve dhe kushteve të mëposhtme:
- a. Ofruesi do të dergojë fillimisht ortakëve të tjerë ekzistues një njoftim me shkrim (postë rekomandë) ku të përcaktohet numri i kuotave të ofruara, si dhe cmimin e kuotave të ofruara, emrin e blerësit dhe kushtet e tjera kontraktuale të transferimit (këtë e tutje referuar si oferta) duke ftuar së pari ortakët ekzistues të blejnë këto kuota të ofruara.
  - b. Ortakët e tjerë kanë të drejtë të blejnë kuotat e ofruara sipas kushteve të ofertes, në përpjestim me përqindjet e zotëruara e zotëruara, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një afati 30 ditor pas marrjes së njoftimit të ofruesit me postë rekomandë.
- 7.3** Në rast se një apo disa nga ortakët ekzistues nuk përgjigjen gjatë afatit të mesipërme apo përgjigjen në mënyrë negative, atëherë ofruesi është i lirë në transferimin e kuotave në favor të paleve të treta pa kufizim, me kushte të njëjta si ato të parashikuara në ofertën e mesipërme.
- 7.4** Parashikimet sa më sipër nuk zbatohen në rastin kur kuotat transferohen ndërmjet ortakëve ekzistues apo tek personat e paralindur apo paslindur në vijë të drejtë të ortakëve ekzistues (fëmijë, bashkeshortë).

##### **Neni 8**

##### **Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit**

- 8.1** Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotëruar ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 8.2** Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të

nje ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zoterues i kuotës ose të kërkojë nga shoqëria likuidimin e saj, në vlerë të percaktuar nga ekspert perkates.

## Kreu IV Asambleja e Përgjithshme

### Neni 9

#### Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë, por pa u kufizuar, për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:
- a. percaktimi i politikave tregtare;
  - b. ndryshime të Statutit;
  - c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
  - d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel të autorizuar;
  - e. miratimi i skemës së shperblimeve për personat e përmendur në shkronjat c. dhe d.;
  - f. mbikeqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë;
  - g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë;
  - h. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
  - i. pjesëtimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
  - j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykime dhe në procedime të tjera kundër administratorit/administratoreve të saj;
  - l. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë;
  - m. miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
  - n. çështje të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht."

- 9.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përmendura në pikat (g) dhe (h) me sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit perkates të dërguar me thirrjen e mbledhjes së asamblese se pergjithshme.
- 9.3 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e minorancës sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi nëpërmjet një njoftimi me letër rekomandë me njoftim marrje të dërguar në adresën e ortakeve apo poste elektronike (email) (adresa të depozituara rregullisht nga ortakët pranë administratorit dhe email të pasqyruar në ekstraktin e shoqërisë në të dhënat vullnetare të tij të pakten 7 dite përpara mbledhjes). Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga të gjithë ortakët që zoterojnë 100% të kapitalit të shoqërisë.

- 9.4 Njoftimi për thirrjen e Asamblese duhet të përmbajë në mënyrë të qartë datën, ditën, kohën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe do t'u dërgohet të gjithë Ortakëve të Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes.

Në rast ndryshimi të rendit të ditës, do të ndiqet e njëjta procedurë njoftimi që përshkruhet më sipër.

#### Neni 10

##### Kuorumi i nevojshëm

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve të zakonshme, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë dhe janë të pranishëm qoftë dhe nepermjet përfaqësuesve të autorizuar, ortakët me të drejtë vote, të cilët zotërojnë jo më pak se 51 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2 Në rastin e marrjes së vendimeve të jashtëzakonshme, që kërkojnë një shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë dhe janë të pranishëm qoftë dhe nepermjet përfaqësuesve të autorizuar, ortakët me të drejtë vote, të cilët zotërojnë jo më pak se 51 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 11

##### Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të jashtëzakonshme me anë të votes pro të një shumicë prej 3/4 të ortakëve pjesëmarrës në mbledhjen e asamblese së përgjithshme rregullisht të mbledhur për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të zakonshme me anën e votes pro të shumicës të ortakëve pjesëmarrës në mbledhjen e asamblese së përgjithshme, rregullisht të mbledhur, dhe vecanerisht mbi çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.  
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.  
Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



11.4 Kryetari i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te jete administratori i shoqerise i cili do te drejtoje mbledhjen dhe asambleja e pergjithshme ne cdo mbledhje te saj do te emeroje me shumice te thjeshte te votave te ortakeve pjesemarres edhe nje person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.

11.5 Çdo vendim i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te regjistrohet ne proces-verbal, i cili do te mbahet ne perputhje me nenin 90 te ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

## Neni 12

### Votat e Ortakëve

12.1 Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit për shoqerite tregtare ne fuqi.

12.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

## Kreu V

### Administratori

## Neni 13

### Emërimi i Administratorit

13.1 Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shume persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave te ortakeve ne Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

13.2 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë "AI Systems " :  
Z. **PETRILLI FELICE ROBRTO**, i biri i Antonio, shtetas Italian, lindur ne CANOSA DI PUGLIA me 12/06/1971 banues ne Canosa di Puglia Via Venezia nr 16 , mbajtes i pasaportes italiane me numer YA8459510;  
Me kontakte: e-mail: [roberto.petrilli@implementa-srl.it](mailto:roberto.petrilli@implementa-srl.it) dhe tel: +39 3474818255

Z. **TRAVERSA CARLO**, i biri i Luigi, shtetas Italian, lindur ne BARLETTA me 31/05/1972 dhe banues ne BARLETTA C.so Garibaldi 226 , mbajtes i katrtes identitetit italiane me numer CA50691EC,

## Neni 14

### Kompetencat e Administratorit

14.1 Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me sipër dhe ligjit tregtar ne fuqi.

14.2 Pa u kufizuar sa me sipër, ne menyre te vecante, Administratori ka keto kompetenca:

- (i) do te drejtoje dhe te perfaqesoje Shoqerine persa i perket administrimit te zakonshem;

- (ii) do të nënshkruaje cdo marreveshje në emer të Shoqërisë;
  - (iii) do të hapë llogari në emer të Shoqërisë me cdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj;
  - (iv) do të përgatise të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruaje cdo kontratë huaje apo kontratë tjetër që parashikon një borxh apo borxh të mundshëm për Shoqërinë, hipotekë, peng apo cdo marreveshje tjetër që krijon apo mund të krijojë një barrë mbi pasuritë e Shoqërisë, marreveshje garancie, kontratë për shitjen e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme të Shoqërisë. Të gjitha veprimet e parashikuara këtu (pika iv) do të jenë të vlefshme nëse janë të autorizuar shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marre me shumicë unanime;
  - (v) do të urdherojë dhe kryejë pagesa në emer të Shoqërisë – duke nënshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
  - (vi) do të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të Shoqërisë;
  - (vii) do të përgatise dhe nënshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
  - (viii) do të krijojë një sistem monitorimi dhe paralajmërimi njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
  - (ix) do të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9723, datë 3 Maj 2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit";
  - (x) do t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
  - (xi) do të përgatise të gjitha planet për zhvillimin dhe operimin e Hidrocentraleve;
  - (xii) do të marrë në punë, emerojë, shkarkojë të punësuar të Shoqërisë për cdo nivel, përfshirë edhe të punësuar me kohë të pjesshme, konsulentë, agjente, do të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do të përcaktojë shpërblimin e tyre;
  - (xiii) do të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, duke pasur parasysh respektimin në cdo rast të kufizimeve të parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhëna me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- (xiii) Do të administrojë adresat dhe kontaktet e ortakëve (tel, email). Në cdo rast ortakët janë të detyruar që menjëherë pas cdo azhurnimi të kontakteve të tij (nr.tel, email, adresë shtepie) të njoftojë administratorin me shkrim, në të kundërt mban përgjegjësi për cdo dëm të shkaktuar nga mosnjoftimi në kohë.

Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa më sipër, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

## Neni 15

### Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. ndodhet ose mund të ndodhet në kushtet e pa-afetësisë fizike;

4. jep doreheqje nga detyra duke njoftuar shoqerine;
5. vdekjeje;
6. ndodhet ne situata apo rrethana te cilat e bejne te pamundur ushtrimin e detyrave te tij;

#### Neni 16

##### Kufizimet në Veprimet e Administratorit

- 16.1 Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për shoqëritë tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqërie, në baze të kuorumit të kërkuar, autorizo lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 16.2 Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### Kreu VI Prishja dhe njoftimet

#### Neni 17

##### 17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
  - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
  - c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
  - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit për shoqëritë tregtare;
  - d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
  - dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
  - e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
- 17.2 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
  - 17.3 Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKR, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKR-se.

#### Neni 18

##### Njoftimet

- 18.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas



pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

- 18.2** Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

#### Neni 19

##### Te Ndryshme

- 19.1** Cdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vlerën e saj.
- 19.2** Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe cdo akt tjetër ligjor dhe nenligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohe pas kohe gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 19.3** Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 19.4** Në fund të cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilet i dërgohen për miratim Asamblese së zakonshme.
- 19.5** Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

#### NENI 20

##### Dispozita përfundimtare

- 20.1** Ky statut perben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve sipas shumicës së cilesuar të përcaktuar më sipër.
- 20.2** Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortakët do të referohen legjislacionit tregtar Shqiptar në fuqi si dhe praktikave tregtare në vend.

Në mungesë të administratorit autorizohet z. ARTUR CELA për kryerjen e veprimeve të regjistrimit pranë zyrave të QKB.

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën Shqip dhe u nënshkrua nga palet pa asnjë rezervë.

#### ORTAKET THEMELUES

PETRILLI FELICE ROBERTO



TRAVERSA CARLO

